



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

VENDIM

Nr. 177, datë 30.10.2024

PËR  
MIRATIMIN E SHOQËRISË “PRICEWATERHOUSECOOPERS ASSURANCE  
SERVICES” SH.P.K., SI SHOQËRI AUDITUESE PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE  
FINANCIARE TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT  
“SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 5, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të neneve 123 dhe 124, të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të rregullores nr. 37, datë 28.05.2015 “Për përcaktimin e kriterëve dhe kërkesave për përzgjedhjen e shoqërisë audituese për shoqërinë e sigurimit”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e shoqërisë audituese “PricewaterhouseCoopers Assurance Services” sh.p.k., për auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë së sigurimit “Sigal Uniqa Group Austria” sh.a., për vitin financiar që mbyllet në 31.12.2024.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR

Deniz DERALLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Mimoza KAÇI